



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 410/1 prot.

Tiranë, më 18. 03. 2022

V E N D I M

Nr. 55, datë 18. 03. 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 48 regj, datë 04.03.2022, të paraqitur nga subjekti ankues, V. R., kundër Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të gjendjes arsimore*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, V. R., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon se, është diplomuar në vitin 2009 në “State University of New York”, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me kampus në Athinë, Greqi në degën “Financë dhe Biznes Ndërkombëtar”, të njohur dhe njehsuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në datë 28.03.2017.

Komisioni i Njohjes së Diplomave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në vitin 2017 ka njohur dhe njehsuar diplomën e lëshuar nga “State University of New York”, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me kampus në Athinë, Greqi në Financë dhe Biznes Ndërkombëtar si Bachelor në Republikën e Shqipërisë.

Ankuesi në dijëni të vendimmarrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me trajtimin e një rasti të ngjashëm, në të cilin me Vendim Nr. 115, datë 27.07.2015, është konstatuar diskriminimi i subjektit ankues I. S., si dhe është kërkuar njehsimi i diplomës së saj në Master Shkencor dhe jo Bachelor.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këto kushte, referuar vendimit të sipërcituar të KMD-së, V. R. i është drejtuar Qendrës së Shërbimeve Arsimore me shkresën datë 17.08.2021, në të cilën ka kërkuar rishikimin e njohjes së diplomës së tij dhe njehsimin e saj nga Bachelor në Master Shkencor.

Me vendimin Nr. 104, datë 15.02.2022, Komisioni i Njohjes së Diplomave, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij për shkak se është paraqitur në tejkallim të afateve të rishqyrtimit të saj.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se është përballur me një situatë diskriminuese nga ana e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke mos i rishikuar dhe njohur diplomën e tij si Master Shkencor. Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të gjendjes arsimore nga ana e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese”*, ankesa e V. R., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Nga aktet e administruara, rezulton se ankuesi pretendon se ndaj tij është kryer sjellje diskriminuese lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Njohjes së Diplomave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në vitin 2017, i cili ka njohur dhe njehsuar diplomën e lëshuar nga “State University of New York”, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me kampus në Athinë, Greqi në Financë dhe Biznes Ndërkombëtar, si Bachelor. Gjithashtu, pretendon se është diskriminuar për faktin se Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk kanë bërë rishikimin e njehsimit të diplomës së tij, për ta njohur atë si Master Shkencor.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka marrë dijëni për sjelljen diskriminuese të pretenduar, që në datë 28.03.2017, me shkresën Nr. 240 prot. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 04.03.2022, pra më vonë se tre vite nga marrja dijëni dhe ndodhja e diskriminimit të pretenduar.

Pra, në përfundim Komisioneri konstaton se janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/dh dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, V. R., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)